



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 595, datë 23.12.2021

PËR

ZGJATJEN E AFATIT TË LEJES PRINDËRORE PËR GJYQTAREN {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 23.12.2021, si u njoh me materialet e çështjes, relacionin “Mbi projektvendimin “Për zgjatjen e afatit të lejes prindërore për gjyqtaren {...}”, përgatitur nga relatorja, znj. Brikena Ukperaj, si dhe pasi shqyrtoi propozimin e Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VËREN:

I. FAKTET E ÇËSHTJES

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 209, datë 20.05.2021, pasi ka shqyrtuar kërkesën e gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, znj. {...} për dhënie “leje prindërore” (leje e papaguar), ka vendosur : “Miratimin e kërkesës së znj.{...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për dhënie leje prindërore për periudhën 14 qershor 2021 – 31 dhjetor 2021...”.

Tridhjetë ditë para përfundimit të afatit të lejes së papaguar, në datë 02.12.2021, me nr. 5506 prot., është regjistruar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kërkesa e gjyqtarës për zgjatje të afatit të lejes prindërore për një periudhë tjetër 7/mujore, deri në datë 31.07.2022.

Në kërkesën me shkrim znj.{...} parashtrohet rrethanat mbi të cilat bazohet kërkesa për zgjatje të afatit të lejes prindërore, duke evidentuar faktin se kërkesa e saj konsiston në të njëjtin shkak të parashtuar prej saj në kërkesën e mëparshme të trajtuar nga Këshilli me vendimin 209/2021. Konkretisht ajo parashtrohet se kërkesa për zgjatje të afatit të lejes prindërore përlligjet nga fakti se duhet të kujdeset për 2 fëmijët e saj në moshë të mitur, dy vajzat e saj binjake të dtl. 19.07.2020, në kushtet kur së bashku me bashkëshortin e saj z. Laurent Fuçia ushtrojnë detyrën në rrethet larg vendbanimit. Sipas përmbajtjes së kërkesës, ushtrimi i detyrës prej saj dhe bashkëshortit në dy gjykata të ndryshme, në distancë të largët nga vendbanimi i tyre në Tiranë, krijon pengesa në lidhje me rritjen dhe kujdesin ndaj dy fëmijëve të mitur.

Gjyqtarja nuk i ka bashkëlidhur kërkesës për zgjatjen e afatit të lejes së papaguar dokumentacion provues, duke parashtuar se shkak mbi të cilin mbështetet kërkesa është i njëjtë me atë të trajtuar në vendimin për dhënie leje së papaguar nga KLGJ.

II. PROCEDURA E ZHVILLUAR

Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me qëllim trajtimin e kërkesës së znj.Lazellari, duke iu referuar parashikimeve të nenit 24, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 72, datë 20.02.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, pasi administroi gjithë praktikën dokumentare që i përkiste vendimit të KLGJ-së nr. 209, datë 20.05.2021, kërkoi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, mendimin e kryetarit lidhur me ngarkesën dhe funksionalitetin e gjykatës.

Zëvendëskryetarja e Gjykatës, nëpërmjet postës elektronike, më datë 07.12.2021, ka përcjellë të dhënat për ngarkesën aktuale të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin pranë kësaj gjykate¹. Njëkohësisht ajo nuk ka dhënë mendim të shprehur qartë lidhur me cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës, por është shprehur se : “*Mendoj se në rastin konkret duhet vlerësuar fakti se, ndërkohë, punohet me organikë të përgjysmuar dhe me ngarkesë të lartë të çështjeve gjyqësore nga ana e gjyqtarëve*”.

Pas përfundimit të procedurës si më sipër, në mbledhjen e datës 10.12.2021, Komisioni vendosi që kjo çështje t’i kalojë për shqyrtim Mbledhjes Plenare.

Çështja u morr në shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit më datë 23.12.2021, brenda afatit 15 ditor nga paraqitja e propozimit në referim të parashikimeve të pikës 6 shkronja “b” të Vendimit nr.72 datë 20.05.2019 të KLGJ.

III. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

Neni 24 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se: “*1. Përveç pushimeve vjetore, magjistrati gëzon të drejtën të marrë në përputhje me Kodin e Punës: a) pushime të tjera; b) leje prindërore.....6. Këshilli përcakton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar.*”

Neni 132/1 i K.Punës parashikon se :

*1. Punëmarrësi, i cili ka më shumë se një vit pune të pandërprerë tek i njëjti punëdhënës, ka të drejtë për një leje të papagueshme, jo më pak se 4 muaj, derisa fëmija që ka në ngarkim të arrijë moshën 6 vjeç. E drejta për të kërkuar lejen prindërore është individuale për secilin prind dhe nuk është e transferueshme, me përjashtim të rasteve kur njëri prind vdes. Leja mund të jepet e ndarë, por jo më pak se një javë në vit. **Kohëzgjatja përcaktohet me marrëveshje me shkrim midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.***

¹ Referuar të dhënave statistikore të dërguara nga Gjykata, rezulton se ngarkesa aktuale, në datën e përcjelljes së informacionit 07.12.2021, është mesatarisht 165 çështje për gjyqtar.

2. Në rastin e birësimit të fëmijës, leja prindërore jepet brenda 6 vjetëve, që nga dita e birësimit të fëmijës, por jo më vonë se kur fëmija mbush moshën 12 vjeç.

3. Punëmarrësi duhet të lajmërojë, me shkrim, punëdhënësin, të paktën dy javë përpara fillimit të lejes prindërore. Punëdhënësi ka të drejtë, pas konsultimit me punëmarrësin, të shtyjë datën e fillimit të lejes, deri në gjashtë muaj, për arsye të cilat kanë të bëjnë me nevojat operacionale të ndërmarrjes, kur punëmarrësi nuk mund të zëvendësohet përkohësisht, kur kjo leje kërkohet njëkohësisht nga shumë punëmarrës ose kur pozicioni i punës është i një rëndësie të veçantë. Punëdhënësi njofton punëmarrësin, me shkrim, brenda dy javëve nga data e kërkesës, për arsyet e shtyrjes së lejes prindërore.

Sa i përket kushteve për dhënien e lejes së papaguar prindërore, në pikën 5 të vendimit të KLGJ nr. 72, datë 20.05.2019, parashikohet se:

..5. Leja prindërore i jepet nga Këshilli, gjyqtarit që ka ushtruar funksionin më shumë se një vit të pandërprerë, si më poshtë;

a. Për një periudhë jo më pak se 4 muaj dhe jo më shumë se dy vjet në total për çdo fëmijë, derisa fëmija që ka në ngarkim, të arrijë moshën 6 vjeç. Përrjashtimisht për raste (shkaqe) të rënda dhe të motivuara, ky afat mund të zgjatet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

b. E drejta për të kërkuar lejen prindërore është individuale për secilin prind dhe nuk është e transferueshme, me përjashtim të rasteve kur njëri prind vdes. Leja mund të jepet e ndarë, por jo më pak se një javë në vit;

ç. Gjyqtari që kërkon këtë leje, e paraqet kërkesën me shkrim në Këshill, të paktën 30 ditë para kohës kur kërkon të fillojë kjo leje si dhe përcakton kohëzgjatjen e saj. Bashkë me kërkesën, gjyqtari paraqet dokumentacionin justifikues dhe mendimin me shkrim nga kryetari i gjykatës;

d. Kërkesa e gjyqtarit trajtohet nga Komisioni përkatës, i cili brenda 7 ditëve i përcjell Mbledhjes Plenare propozimin për miratimin e lejes dhe afatin e fillimit të saj. Këshilli merr vendim për këtë kërkesë brenda 15 ditëve nga paraqitja e propozimit. Në vendimin për dhënien e lejes, Këshilli shprehet edhe në lidhje me rihedhjen ose jo në short, të çështjeve që gjyqtari ka në shqyrtim.

e. Në rast të cenimit të funksionalitetit apo përmbushjes së detyrës me efikasitet dhe në kohë, Këshilli mund të shtyjë datën e fillimit të lejes deri në 6 muaj.

IV. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

Ligji për Statusin, si pjesë e garancive të parashikuara nga neni 138 i Kushtetutës që kanë për qëllim të sigurojnë pavarësinë e sistemit gjyqësor, përveç pushimeve vjetore, ka parashikuar edhe të drejtën e magjistratit për të përfutuar pushime të tjera. Në këtë kontekst neni 24 i këtij Ligji ka si qëllim që, nëpërmjet përcaktimit të llojeve të pushimeve të tjera dhe rregullave për marrjen e tyre, të krijojë kushtet e përshtatshme për të pasur një sistem gjyqësor efektiv dhe funksional, i cili nuk është privilegj apo qëllim në vetvete, por i shërben

garantimit të një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër dispozita ka pasur si qëllim të mbrojtjes edhe të drejtën e marrjes së pushimeve të tjera nga magjistratët, veç lejen e tyre vjetore, duke e parashikuar një të drejtë të tillë drejtpërdrejt në ligj, çka e bën atë element të garancive funksionale për magjistratët.

Ligji për Statusin, për herë të parë, duke thirrur për zbatim nenin 132/1 të K.Punës, i ka njohur gjyqtarëve të drejtën për të përfiturar “leje prindërore”. Kjo e fundit ka si qëllim të krijojë për gjyqtarët kushtet e nevojshme për gjetjen e një balance ndërmjet detyrimeve që lindin për shkak të detyrës dhe të drejtës për jetë familjare.

Në kuadër të garantimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, të sanksionuar në Kushtetutë, ligjvënësi me qëllim përafrimin e legjislacionit me Direktivat e BE-së, me ligjin 136/2015 por që ka hyrë në fuqi në dt. 22.06.2016, ka parashikuar “Lejen Prindërore” si e drejtë vetjake (e patransferueshme) e punëmarrësit, që nuk mund t’i refuzohet nga punëdhënësi, nëse punëmarrësi plotëson kushtet e dispozitës dhe që duhet konceptuar si mundësi e prindit për t’iu përkushtuar në kohë fëmijës që rritet. Qëllimi i lejes prindërore, është të mundësojë dhe risë zhvillimin social të marrëdhënieve prindërore, midis prindërve në marrëdhënie pune dhe fëmijëve të tyre, në fazën e parë të jetës që lidhet me fëmijërinë, ose në rastin e prindërve birësues, që lidhet me periudhën direkt pas birësimit. Ligjvënësi, parashikon që kjo leje është individuale, pra që ajo i jepet secilit prind në mënyrë të pavarur, dhe nuk është e transferueshme. Kjo përpjekje bëhet me qëllim të shpërndarjes sa më të barabartë të përgjegjësisë prindërore, tek të dy prindërit, sepse të dy prindërit duhet të lidhen emocionalisht me fëmijët e tyre. Kjo është edhe arsyeja pse leja, përveç në rast të vdekjes së njërit nga bashkëshortët, nuk është e transferueshme. Ajo lidhet me një detyrim prindëror individual, ku secili nga prindërit ka përgjegjësinë e vet në mënyrë të barabartë.

Të drejtën e përfitimit të “lejes prindërore” e ka çdo gjyqtar, që plotëson të njëjtat kriteret të vendosura në K.Punës. Sipas nenit 132/2 të Kodi i Punës, gjyqtarët mund të përfitojnë lejen prindërore vetëm pasi të kenë ushtruar funksionin për më shumë se një vit të pandërprerë tek i njëjti punëdhënësi. Leja prindërore është e papagueshme dhe merret për një periudhë jo më të vogël se 4/muaj, derisa fëmija që ka në ngarkim gjyqtari të arrijë moshën 6/vjeç. Sipas parashikimeve të K.Punës leja mund të jepet e ndarë, pra nëse i referohemi minimumit, jo në çdo rast ajo mund të jepet për 4/muaj të njëpasnjëshëm, por gjithmonë me një kohëzgjatje jo më pak se 1 javë në vit.

Kodi i Punës ka vendosur kufirin minimal, por jo atë maksimal të kohëzgjatjes së lejes prindërore për gjyqtarët, duke sanksionuar parimin se : **“Kohëzgjatja e lejes prindërore përcaktohet me marrëveshje me shkrim mes punëdhënësit e punëmarrësit”**. Bazuar në këtë parashikim ligjor Këshilli në pikën 5 të vendimit nr. 72, datë 20.05.2019, ka parashikuar se leja prindërore i jepet gjyqtarit për një periudhë jo më pak se 4 muaj dhe jo më shumë se dy vjet në total për çdo fëmijë, derisa fëmija që ka në ngarkim, të arrijë moshën 6 vjeç.

Përrjashtimisht për raste (shkaqe) të rënda dhe të motivuara, ky afat mund të zgjatet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Në rastin konkret Këshilli në vendimin e tij Nr. 209 dt. 20.05.2021 ka vlerësuar se gjyqtarja {...} plotëson kushtet për përfitimin e lejes prindërore, por si kohëzgjatje të saj ka parashikuar periudhën 14.06.2021-31.12.2021. Gjyqtarja vazhdon të jetë në të njëjtat rrethana të analizuara në këtë vendim, me ndryshim të moshës së dy fëmijëve, të cilët tashmë janë përafërsisht 1 vjeç e 6/muaj.

Në kushtet kur Këshilli brenda afatit 2/vjeçar, nuk mund t'i refuzojë gjyqtarit dhënien e lejes prindërore dhe për znj. {...} këto kushte plotësohen sikundër është arsyetuar edhe më parë prej Këshillit, çështja që shtrohet për diskutim është nëse Këshilli duhet të pranojë zgjatjen e afatit të lejes prindërore të dhënë më parë për një periudhë tjetër 7/mujore, e cila bashkë me kohëzgjatjen e parë nuk e tejkalon afatin 2/vjeçar, apo duhet të vendosë sipas nenit 132/1 pika 3 të K.Punës, duke e shtyrë me 6/muaj afatin e fillimit të një leje të re prindërore sipas nenit 132/1 pika 3 të K.Punës.

Ndarja e lejes prindërore sikundër edhe shtyrja e datës së fillimit të saj, në referim të nenit 132/1 të K.Punës, kërkojnë marrëveshje me shkrim midis punëdhënësit e punëmarrësit. Nga ana tjetër refuzimi nga ana e Këshillit e zgjatjes së afatit të lejes prindërore së dhënë, në kushtet kur gjyqtarja vazhdon të kërkojë të përfitojë nga e drejta për leje prindërore, detyron Këshillin që për sa kohë ai nuk mund të refuzojë “lejen prindërore”, të vendosë vetëm për shtyrjen e afatit të fillimit të një leje tjetër prindërore. Por shtyrja e afatit të fillimit të një leje të re prindërore me 6/muaj, veç dëmtimit të interesit më të lartë të fëmijës i vlerësuar si i tillë nga vetë prindi, nuk ndihmon në rritjen e efektivitetit të gjykatës, madje mund ta dëmtojë më shumë atë, sepse gjyqtarja do të duhet të ridorëzojë të gjitha çështjet që do të ketë për shqyrtim në dt. 01.07.2022. Pavarësisht numrit të reduktuar të gjyqtarëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, pasi nga 14 gjyqtarë në organikë aktualisht në detyrë janë 7/gjyqtarë, kjo gjykatë vazhdon të jetë funksionale.

Sa më sipër vlerësohet se në rastin konkret, zgjatja e afatit të lejes prindërore sipas kërkesës së gjyqtarës, në kushtet kur nuk jemi para një afati procedural, në zbatim të parimit të proporcionalitetit, do të dëmtonte më pak nevojat dhe efektivitetin e gjykatës, sesa shtyrja me 6/muaj e afatit të fillimit të një leje tjetër prindërore (leja prindërore brenda afatit 2/vjeçar, mund të jepet e ndarë për disa periudha).

V. KONKLuzioni

Për sa arsyetohet më lart, Këshilli vlerëson se kërkesa e gjyqtarës {...} për zgjatjen e afatit të lejes prindërore, për një periudhë tjetër 7/mujore, përmbush kriteret e përcaktuara në

nenin 24, të ligjit nr. 96/2016, nenit 132/1 të K.Punës si dhe vendimit nr.72, datë 20.05.2019 për “Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor” dhe si e tillë duhet të pranohet. Në lidhje me të drejtën e ankimit, në referim të parashikimeve të nenit 100 të Ligjit nr.115/2016 ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 61, 68 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 24, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 132/1 të K.Punës dhe vendimin nr. 72, datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”,

VENDOSI :

1. Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për zgjatjen e afatit të lejes prindërore të dhënë me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.209, datë 20.05.2021, për një periudhë tjetër 7-mujore, deri në datë 31.07.2022.
2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR